



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 33, datë 05.04.2016

PËR “MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË TIRANËS ”

Në mbështetje nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b” nenit 54 shkronja “ç”, nenin 55, pika 2 dhe 6, nenin 69 pika 3, nenin 71, pika 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 115/ 2014, datë 31.07.2014 për “Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5 të Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84, datë 29.12.2016,për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 20 001 – 50 000 banorë, sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 50 001 – 100 000 banorë, sipas lidhjes nr.2 bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 5 001 – 20 000 banorë, sipas lidhjes nr.3 bashkëngjitur këtij vendimi.
4. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Njësive Administrative me më pak se 5 000 banorë, sipas lidhjes nr.4 bashkëngjitur këtij vendimi.

5. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit administrativë të Njësive Administrative, sipas lidhjes nr.5 bashkëngjitur këtij vendimi.
6. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Mars të vitit 2017 dhe do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2017.
7. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Financës.
8. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.29, datë 23.05.2016 për “Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Njësive Administrative të Tiranës, shfuqizohet.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

Lidhja Nr. 1 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 20 001 – 50 000 banorë

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	99 000
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	45 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	44 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	37 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	31 000

Lidhja Nr. 2 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me mbi 50 000 banorë

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	115 000
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	48 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	44 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	37 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	31 000

Lidhja Nr. 3 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 5 001 - 20 000 banorë

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	85 000
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	38 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	35 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	33 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	30 000

Lidhja Nr. 4 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me më pak se 5 000 banorë

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	60 000
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	36 000
Përgjegjës Zyre, Specialist	III	b	1ose 2	2%	34 000
Specialist	IV	a	1ose2ose3	2%	32 000
Specialist	IV	b	1ose2ose3	2%	30 000

Lidhja nr. 5 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ të Njësive Administrative

Nr	Emërtimi	Klasa	Paga Bazë	Shtesa për vjetërsi ne %
1	Specialist me arsim te mesëm, Topograf	VI	35 000	1%
2	Arkivist-protokollist	V	34 000	1%
3	Punonjës shërbimi, Magaznier	IV	33 000	1%
4	Shofer	III	32 000	1%
5	Punëtor shërbimi, mirëmbajtës	II	31 000	1%
6	Pastruese, Roje	I	30 000	1%

Shtesa për vjetërsi në punë **për Lidhjen nr. 5** të jepet **në masën 1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën bazë të klasës së I.**